



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 23.4a.1-2017-08**

## **RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE PËR FONDET NË  
MIRËBESIM PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit Sabile Musa dhe Anëtarët e ekipit Kreshnike Haziri, Mazlumshah Sejfadini dhe Shqiponja Krasniqi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	22
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	25

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 25/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së shpenzimeve për Ofruesit e Shërbimeve Profesionale të përkrahur në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Fondeve në Mirëbesim në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i kualifikuar

Ne kemi audituar PFV-të të Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave të Fondeve në Mirëbesim, bilancin bankar të pranimeve dhe shpenzimeve, gjendjen e llogarive bankare të Fondeve në Mirëbesim, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullës për Kornizën Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim, e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve me 23 shkurt 2011.

#### Baza për opinion të kualifikuar

Pagesat për Ofruesit e Shërbimeve Profesionale për vitin 2017 në vlerë prej 996,000€ ishin kryer nga Fondi i Mirëbesimit, në kundërshtim me rregullat në fuqi. Bazuar në nenin 16 të shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit kompensimet për Ofruesit e Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit) duhet të paguhet nga mjetet që i janë ndarë Agjencisë nga buxheti i Republikës së Kosovës ose nga mjetet e siguruar nga një donator. Për këtë arsye është kualifikuar opinionimi.

Këto mjete ishin paguar nga Fondi i Mirëbesimit pasi që AKP-së nuk i ishin ndarë mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës, përkundër kërkesave të vazhdueshme nga ana e menaxhmentit. Përpjekjet e menaxhmentit të AKP-së, kishin rezultuar të suksesshme, vetëm pas përfundimit të vitit fiskal 2017, kur Kuvendi i Kosovës ka amendamentuar ligjin e AKP-së<sup>1</sup>. Pos tjerash, ndryshimet kanë përfshirë edhe nenin 16 të këtij ligji, sipas të cilit, pagesat për Ofruesit e Shërbimeve Profesionale bëhen nga llogaritë e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, për të cilat arsye edhe është kualifikuar opinionin. Auditori i Përgjithshëm nuk ka mundur t'a konsideroj këtë fakt me rastin e dhënies së opinionit pasi ligji nuk ka veprim retroaktiv dhe opinionin është dhënë për Pasqyrat Financiare të përfunduara me 31 dhjetor 2017, por e ka parë të nevojshme, që ta shpalos këtë sqarim shtesë siç është përshkruar këtu, në mënyrë që menaxhmenti i organizatës, Parlamenti i Kosovës dhe publiku të informohet lidhur me njohjen e të drejtës së pagesave nga Fondi i Mirëbesimit nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit të ri, saktësisht siç kishte vepruar menaxhmenti gjatë vitit fiskal 2017.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është e pavarur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin brendshëm të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondeve në Mirëbesim.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 06/L-023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Me Ligjin Nr. 05/L-080.

---



Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencia kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063);
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Pajtueshmëri me kornizën raportuese të pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat tjera për raportim të fondeve në mirëbesim, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore.

Në kontekst të PFV-ve, kemi një çështje për të ngritur:

- Vlera e prezantuar e detyrimeve kontingjente në PFV të Fondeve në Mirëbesim ishte 5,432,014€. Në këtë vlerë përfshihen obligimet e mundshme financiare që priten nga zhvillimet në të ardhmen. Mirëpo kjo vlerë nuk ishte e plotë, pasi ne i kemi testuar nëntë mostra, dhe pesë prej tyre me vlerë prej 138,700€ nuk ishin shpalosur në PFV. Me tutje, AKP mban regjistrat për rastet gjyqësore që nuk janë zgjidhur ende, por pa vlerë të mundshme financiare, prandaj kjo ka rezultuar në një pasiguri mbi vlerësimin e të gjitha detyrimeve kontingjente.

Të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm ishin përmbushur me një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në këtë aspekt.

## Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që të gjitha shpenzimet buxhetohen, realizohen dhe raportohen në përputhje me Legjislacionin në fuqi.

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare lidhur me shpalosjen e detyrimeve kontingjente. Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore.

Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i Fondeve në Mirëbesim, Pranimet në llogaritë bankare, pagesat/shpërndarjet nga llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) që Agjencia menaxhon dhe administron në Bankën Qendrore të Kosovës, dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi pranimet dhe pagesat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar, megjithatë disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në vitin 2017, Agjencia kishte një performancë të kënaqshme nga fakti që pas një periudhe pothuajse dy vjeçare kishte filluar me shitjen e asetëve të NSh-ve. Shitjet kanë ndodhur sipas periudhave mujore, gjithsej janë realizuar 12 valë të shitjeve duke përmbyshur planin e punës për vitin 2017.

Mangësi janë identifikuar në disa procese të menaxhimit financiar dhe kontrollit e ku si fusha më me prioritet që kërkojnë më shumë përmirësime janë: pagesat për ofruesit e shërbimeve profesionale, procesi i menaxhimit të shpërndarjes së plotë të 20% për punëtorët e NSh-ve, dhe monitorimi i afateve të kontratave të qirave.

### 3.1 Pranimet dhe Pagesat e Fondeve në Mirëbesim

Ne i kemi shqyrtuar pranimet në llogaritë bankare, pagesat/shpërndarjet si dhe bilancin bankar të pranimeve dhe shpenzimeve. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Pasqyra e Gjendjes së llogarive bankare të Fondeve në Mirëbesim (në €uro)

Përshkrimi	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2016	Pranime/ Shpenzime Janar -Dhjetor 2017	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2017
<b>Pranimet</b>			
<b>Gjithsej pranimet</b>	<b>742,851,594</b>	<b>39,866,192</b>	<b>782,717,786</b>
Të hyrat nga shitjet	666,082,049	31,087,867	697,169,916
Të hyrat nga qiraja	26,034,444	6,528,207	32,562,651
Interesi i fituar	34,844,700	0.00	34,844,700
Tarifa për tenderët e shitjes dhe konfiskimet e BID deponitave	7,577,564	652,400	8,229,964
BID deponitat e ofertuesve	592,320	1,438,500	2,030,820
Të hyrat tjera	6,707,317	159,218	6,866,535
Kapitali themeltar i Agjencisë	1,013,200	0.00	1,013,200
<b>Pagesat / Shpërndarjet</b>			
<b>Gjithsej Shpenzimet/Shpërndarja</b>	<b>281,890,244</b>	<b>29,528,661</b>	<b>311,418,904</b>
20% i punëtorëve i transferuar në BSPK	109,973,567	9,283,737	119,257,304
Ofruesi i shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	14,423,930	996,000	15,419,930
Mallra dhe shërbime	12,186,335	2,194,849	14,381,184
Shërbime Publike	1,262,807	731,503	1,994,309
Tatimet	3,288,605	1,723,361	5,011,966
Vendimet e Gjykatave/ përmbaruesve	1,774,806	33,405	1,808,211
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	32,148,000	6,100,000	38,248,000
Shpenzime tjera	715,255	34,286	749,541
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-së	15,872,028	8,105,856	23,977,884
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	90,244,911	325,664	90,570,575
<b>Bilanci bankar i pranimeve dhe pagesave</b>	<b>460,961,349</b>	<b>10,337,531</b>	<b>471,298,882</b>

Nga tabela vërejmë se Bilanci bankar i pranimeve dhe shpenzimeve është në nivel më të lartë si rezultat i shitjeve përmes valëve të privatizimit dhe likuidimit. Gjatë vitit 2017 janë nënshkruar 211 kontrata për shitje të aseteve me vlerë prej 26,851,569€.

Deri më tani janë gjithsej 501 Ndërmarrje Shoqërore për të cilat ka filluar procesi i likuidimit. Gjatë vitit 2017 i janë transferuar Qeverisë së Kosovës fonde të mbetura në vlerë prej 325,664€ nga llogaria bankare e NSh-së MIT046"Den Des", pasi që procesi i likuidimit për këtë NSh ka përfunduar dhe me vendim të gjykatës është mbyllur kjo Ndërmarrje.

Çështjet lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga Fondi i Mirëbesimit për shpenzimet e Ofruesit e Shërbimeve Profesionale janë prezantuar tek nënkapitulli i Opinionit të Auditimit.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.2 Të hyrat

### 3.2.1 Të hyrat nga qiratë

AKP aplikon dy mënyra të dhënies me qira të aseteve: qiratë e zakonshme (NSH në tranzicion dhe NSh në likuidim) dhe qiratë e komercializimit gjatë periudhës së tranzicionit të NSh-ve. Mirëpo gjatë vitit 2017 janë realizuar të hyra nga qiratë e zakonshme, ndërsa të hyra nga komercializimi nuk ka pasur, sepse këto asete të NSh-ve ose janë shitur ose janë në proces të likuidimit.

### Çështja 2 – Realizimi i të hyrave nga qiratë me kontratë të skaduar

**E gjetura** Në dy raste kemi vërejtur që objektet me qira të dhëna nga AKP janë shfrytëzuar nga qiramarrësit edhe pas skadimit të kontratës, dhe AKP nuk kishte bërë vazhdimin apo ripërtëritjen e këtyre kontratave.

Njëra kontratë kishte skaduar në vitin 2014<sup>2</sup> ndërsa qiraja është ende duke u arkëtuar bazuar në kontratën fillestare dhe tjetra kishte skaduar në shtator 2016<sup>3</sup> ndërsa qiraja ishte arkëtuar deri në maj të 2017 pa kontratë valide.

**Rreziku** Mbajtja në shfrytëzim e objekteve me qira pa kontratë valide, rritë rrezikun e mos arkëtimit të qirasë nga qiramarrësi. Po ashtu, vlera e tregut të qirave mund të ketë pësuar ngritje dhe mos ripërtëritja e kontratave të qirasë mund ta dëmtoj shumën e inkasuar të të hyrave.

**Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ripërtëritjen e kontratave me qëllim që shfrytëzimi i aseteve të NSh-ve të bëhet konform kontratave valide dhe në bazë të rregullores së brendshme për qiratë.

<sup>2</sup> Company 21, NSh Rilindja Shtypshkronja

<sup>3</sup> Procredit Banke SH.A, NSh Gërmija

### 3.3 Pagesat / Shpërndarjet e 20% të punëtorëve të transferuar në BSPK

AKP, 20% të shitjeve të NSH-ve i transferon në llogari bankare të BSPK-së<sup>4</sup> për shpërndarje punëtorëve të kualifikueshëm. Pastaj BSPK bënë shpërndarjen sipas listës së miratuar. Për vitin 2017, gjithsej bilanci i pagesave për shpërndarje ka arrit vlerën prej 9,283,737€.

Nga kjo vlerë kanë përfituar 10,231 punëtorë të 73 Ndërmarrjeve Shoqërore. Ndërsa për rastet që ka ankesa, mbahen në llogari të fondeve në mirëbesim të cilat i administrojnë AKP-ja. Gjendja bankare që mbahet në mirëbesim deri në zgjedhjen e këtyre kontesteve gjyqësore është 15,400,400€.

#### Çështja 3 – Shpërndarja jo e plotë e 20% të punëtorëve

**E gjetura** AKP në të kaluarën është ballafaquar me shumë pakënaqësi nga punëtorët e kualifikueshëm<sup>5</sup> për shkak të vonesave që kanë ndodhur në transferin e fondeve të 20%, pas çdo shitje të aseteve të NSH-ve. Bazuar në Memorandumin për bordin e drejtorëve të muajit maj 2013, për ta tejkaluar këtë vështirësi AKP po aplikon shpërndarjen e pjeseshme, duke llogaritur 90% të fondeve të 20%. Ndërsa fondi prej 10% i shumës së mbetur mbahet në fondin e mirëbesimit për punëtorët, për rastet e gabimeve në përlllogaritje, dhe rastet e ankesave të suksesshme kundër vendimit të DhPGjSK<sup>6</sup>.

Po ashtu, në këtë fond mbahet dhe fondi për rastet për të cilat ka ankesa në DhPGjSK. Për periudhën janar – gusht 2017 ne kemi vërejtur se nuk është bërë shpërndarja e 10% dhe pjesës tjetër të rasteve kontestuese për të gjithë punëtorët e kualifikueshëm. Derisa për periudhën e fund vitit kemi vërejtur përmirësime lidhur me shpërndarjen e fondeve në mirëbesim për rastet kontestuese.

**Rreziku** Mbajta pezull e një pjese të mjeteve në afat të pacaktuar kohor, shkakton vonesa në shpërndarjen e mjeteve tek përfituesit potencial dhe rrjedhimisht rritë pakënaqësinë e ish punëtorëve të NSH-ve. Si rezultat i kësaj, AKP mund të ballafaqohet përsëri me presionin e ankesave dhe me procese gjyqësore për shkak të padive nga përfituesit e fondeve.

**Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet se pas përfundimit të procedurave relevante të ankesave të bëhet shpërndarja e plotë e 20% që ju takon punëtorëve pas çdo shitje të aseteve të NSH-ve.

<sup>4</sup> Bashkimi i Sindikatave të Punëtorëve të Kosovës

<sup>5</sup> Punëtorët e kualifikueshëm - janë personat të cilët i kanë plotësuar të gjitha kriteret për të qenë përfitues të 20%.

<sup>6</sup> Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës

### 3.4 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishte 61,791,072€. Prej tyre 8,253,813€ i përkasin vitit 2017 kurse 53,537,259 € janë të arkëtueshme të bartura nga vitet paraprake si obligime të papaguara nga operatorët ekonomik ndaj Agjencisë. Ato kanë të bëjnë me pjesët e papaguara nga valët e privatizimit apo likuidimit, ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special” dhe qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSh-ve.

Rritja e të arkëtueshmeve në vitin 2017 vjen kryesisht si rezultat i një numri më të madh të valëve të shitjes dhe nënshkrimit të kontratave të shitjes në periudhën e fund vitit e të cilat në tremujorin e parë të vitit aktual ishin arkëtuar.

AKP ka filluar të ndërmarr masa për inkasimin e llogarive të arkëtueshme përmes gjykatës, përmbaruesve privat dhe ndëshkimeve financiare.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Obligimet e papaguara

Vlera e llogarive të pagueshme në fund të vitit 2017 ishte 376,993€, prej tyre 304,950€ ishin obligime ndaj kërkesave të kreditorëve, ndërsa 72,043€ janë për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse. Këto detyrime janë bartur për t’u paguar në vitin 2018.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me nëntë rekomandime. Agjencia kishte përgatitur planin e veprimtimit ku kishte paraqitur afatet dhe mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Prej nëntë rekomandimeve të dhëna në auditimin e vitit 2016, një rekomandim është zbatuar, ndërsa tetë ishin në proces të zbatimit. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur gjashtë rekomandime, prej tyre në vitin 2017, dy janë zbatuar dhe katër janë në proces të zbatimit.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Edhe përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e dhëna, një numër i tyre janë në proces të zbatimit. Rekomandimet që janë në proces të zbatimit ndërlidhen me pagesat nga fondi për Ofruesit e Shërbimeve Profesionale, të hyrat nga qiratë dhe shpërndarjen e 20% të punëtorëve. |
| <b>Rreziku</b>       | Mos adresimi i plotë i rekomandimeve rrit rrezikun e përsëritjes së mangësive të njëjta, dhe ndikon që kontrollet e brendshme dhe sistemet kryesore financiare të jenë në vazhdimësi jo efikase për të përmbushur objektivat e përcaktuara.  |
| <b>Rekomandimi 4</b> | Kryesuesi i Bordit duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve që janë në proces të zbatimit, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e plotë të tyre, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.   |



## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse AKP për Fondin e Mirëbesimit ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Një progres i lehtë vërehet në adresimin e rekomandimeve nga auditimi paraprak. Mbetet sfidë edhe më tutje adresimi i plotë i rekomandimeve të ZKA-së.

Bordi i drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë, përbëhet nga tetë anëtarë. Mandati i gjashtë anëtarëve të bordit ka përfunduar me 17 dhjetor 2017. Deri në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të ri edhe komiteti i auditimit mbetet jo funksional.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së, dy auditorë dhe një zyrtar administrativ. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Planin vjetor të punës ishte hartuar në përputhje me planin strategjik, ku ishin përcaktuar disa fusha për auditim për vitin 2017.

NjAB për këtë vit ka planifikuar tetë auditime, prej të cilave gjashtë i kishte përfunduar gjatë vitit 2017 kurse dy ishin finalizuar në fillim të 2018. Përveç finalizimit me kohë të një numri të

konsiderueshëm të raporteve ato ishin mjaft përmbajtjesore. Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të AKP-së.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## **5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut**

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtja e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguuar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

AKP ka vendosur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm që përfshinë raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara në drejtim të arritjes së objektivave. Linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes raporteve dhe takimeve të rregullta.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara gjatë 2017
1.4 Pajtueshmëria me Pasqyrat Financiare	Kryesuesi i Bordit të rishqyrtojë mundësinë e përfshirjes së shpenzimeve të likuidimit në buxhetin e Agjencisë, në mënyrë që fondet në mirëbesim të mos zvogëlohen përmes transferimeve për ti mbështetur shpenzimet e Agjencisë.		Gjatë vitit 2017 AKP kishte ndërmarrë veprimet për të ndryshuar ligjin e saj. Në muajin maj të vitit 2018 është aprovuar dhe publikuar në gazetën zyrtare.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak.	Kryesuesi i Bordit të sigurojë zbatimin e plotë dhe me kohë planin e rishikuar për adresimin e rekomandimeve. Kjo duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore dhe arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraparak duhet të përcaktohen nga zyrtarët relevant dhe t'i raportohen menaxhmentit.	Po		
3.1.2 Të hyrat nga qiratë	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se të gjitha kontratat për qiratë të jenë të nënshkruara nga qiramarrësi.		Përkundër përmirësimeve të bëra, ende kemi identifikuar dobësi në menaxhimin e kontratave mbi qiratë.	
3.2.2 Ofruesi i shërbimeve profesionale	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që Ofruesit e Shërbimeve Profesionale kanë shtuar dinamikën e kryerjes së punëve si dhe hartimin e raporteve finale të likuidimit, në mënyrë që procesi i likuidimit të përfundojë brenda afatit kohor të paraparë me kontratë. Po ashtu, të sigurojë që në kontratën eventuale të ardhshme, të parashihet që kërkesat kolektive të së njëjtës natyrë të mos trajtohen si individuale në mënyrë që të kursehet kohë dhe mjete financiare.		Janë marr masa, megjithatë ekzistojnë vonesa në përmbylljen e procesit të likuidimit të NSh-ve.	

3.3 Llogaritë e arkëtueshme	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë hartuar afate të qarta kohore përmbledhjen e të arkëtueshmeve dhe marrjen e masave ligjore për t'i realizuar ato.		Janë marr masa, mirëpo ende nuk vërehet një trend i rritjes së arkëtimit, krahasuar me periudhat e kaluara.	
3.4 Llogaritë e pagueshme	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është ndërtuar një sistem i besueshëm i kontrollit për pranimin e faturave, pagesën e tyre brenda afatit ligjor si dhe prezantimin e obligimeve në PFV.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.1 Opinioni i Auditimit	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale të bëhen nga buxheti i ndarë për Agjencinë.		Gjatë vitit 2017 AKP kishte ndërmarrë veprimet për të ndryshuar ligjin e saj. Në muajin maj të vitit 2018 është aprovuar dhe publikuar në gazetën zyrtare.	
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Drejtori Menaxhues dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Janë marr masa, bëhen harmonizimet mujore me departamentin e shitjes dhe departamentet tjera përkatëse, nuk kemi vërejtur diferenca në krahasim me PFV-të. Me përjashtim shpalosja e detyrimeve kontingjente nuk ishte e plotë.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Janë marr masa, megjithatë një pjesë e rekomandimeve janë adresuar vetëm pjesërisht.	

2.2.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave të synuara të AKP-së brenda një periudhe të arsyeshme kohore.		Janë marr masa, në parandalimin e gabimeve sa i përket arkëtimit të Llogarive të Arkëtueshme, Llogarive të pagueshme dhe pagesave të Ofruesit për Shërbime Profesionale.	
3.2 Pranimet / të hyrat nga qiratë	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për të adresuar, si çështje urgjente, menaxhimin e asetëve të NSH-ve dhe të hyrave nga qiratë në pajtueshmëri me rregulloren për dhënie me qira.		Nuk kemi hasur mangësi lidhur me miratimin e listave të propozimeve, me përjashtim të dy rasteve në të cilat pa nënshkrim të kontratës vazhdon shfrytëzimi i objekteve nga qiramarrësi.	
3.3.1 Ofruesi i Shërbimeve Profesionale	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për përmirësimin e performancës që procesi i likuidimit të finalizohet në afatin e përcaktuar kohor.		Janë marr masa, megjithatë ekzistojnë vonesa në përmbylljen e procesit të likuidimit të NSH-ve.	
3.3.2 Shpërndarjet e 20% tek punëtorët e NSH-ve të shitura	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se listat e shpërndarjes se 20% tek punëtorët të përmbajnë të dhënat e nevojshme për shpërndarjen e mjeteve në mënyrë të saktë dhe efikase tek përfituesit.		Në pjesën e fundit të vitit kemi vërejtur përmirësime lidhur me shpërndarjen e fondeve në mirëbesim për rastet kontestuese.	
3.4 Llogarite e Arkëtueshme	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të hartuar procedura të duhura dhe të qarta për trajtimin me kohë dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.		Janë marr masa, mirëpo ende nuk vërehet një trend i rritjes se arkëtimeve, krahasuar me periudhat e kaluara.	
3.5 Obligimet e papaguara	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Departamenti i Financave në kuadër të raportimit të rregullt mujor tek menaxhmenti përfshin edhe raportimin e llogarive të pagueshme.	Po		



## Shtojca III: Letërkonfirmimi



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të **Fondeve në Mirëbesim**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ekrem HAJDARI

Drejtor Menaxhues

Data: 18 qershor 2018, Prishtinë